

NDIKIMI I PANDEMISË NË SPORTIN VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

EKSPOZE E PUNIMIT MASTER

NGA

ADNAN BERISHA



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I SOCIOLOGJISË

STUDIME PASUNIVERSITARE - MASTER

PRISHTINË
2022

NDIKIMI I PANDEMISË NË SPORTIN VENDOR DHE NDËRKOMBËTAR

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Shemi Krasniqi

Kandidati: Adnan Berisha

Parimisht pandemia ndikoi në industrinë e sportit dhe në secilën fushë të aktivitetit fizik. Mirëpo një gjë duhet të dimë që, ajo që e ndërlikon këtë proces është boshllëku financiar i krijuar nga pezullimi i aktivitetit ekonomik dhe social në nivel kombëtar dhe në mbarë vendin. Dhe aktivitetet sportive sjellin pjesën e tyre të rrezikut në kohën e pezullimit, edhe mungesa e aktivitetit fizik mbart rreziqet e saj. Të mos harrojmë sportin bazë dhe çdo instancë e sportit që u ndikua nga kjo periudhë epaprecedentë.

Ky studim analizon kontekstin e rrethanave nëpërmjet të cilave u zhvillua sporti nën ndikimin e pandemisë, kufizimet e vendosura, anulimi i garave të gjitha këto, duke iu referuar arenës së sportit ndërkombëtar si dhe atij vendor, por në fokus do shtjellohet dhe futbollit, si një ndër industritë e para dhe më të paguara në botë. Respektivisht do analizohet fakti sesa sfiduese ishte për botën e sportit përfshirja e një situate të tillë, ku rreziku ishte shumë i lartë që nga periudhat të fillimit të vitit 2020, e deri kohërave të fundit të vitit pasues. Poashtu të arriturat e sportit vendor kundrejt praktikave sfiduese të pandemisë. Premisat kryesore mbi të cilat u ndërtua studimi janë: analiza, hulumtime, publikime shkencore të literaturave botërore, ku pasqyrë e gjithë kësaj do jetë, mbarëvajtja e sportit krahas rrezikut nga një epidemi globale, ecuria e zhvillimit të saj, publikimi dhe analizimi i ngjarjeve më të historit që njeh bota e sportit. Të arriturat kundrejt sfidave, si dhe shtrirja ndikimit në jetën shoqërore politike e kulturore.

Ky punim masteri përmban hyrjen, tre kapituj dhe konkluzionin

Në hyrje të këtij punimi janë shtjelluar në mënyrë të përgjithshme motivet për zgjedhjen e temës, metodat e studimit, si dhe çfarë rëndësie ka ky punim për literaturën shkencore dhe shoqërinë në përgjithësi.

Kapitulli I – Ndikimi i pandemisë në sportin vendor: Ky kapitull përmban një trajtim të kornizave teorike mbi sportin dhe problematikat të cilat u hasën përgjatë pandemisë, sesa sfiduese ishte kjo periudhë si dhe rrjedhojat e zhvillimit të arënës sportive, aranzhimi i kompeticioneve, pezullimi i ndeshjeve. Bankrotimet dhe problemet financiare, si dhe njëkohësisht, rikthimi i sistemit sportiv në arenën e sportit vendor. Të gjitha këto trajtohen në këtë kapitull dhe pasqyrojnë një realitet kohor.

Kapitulli II – Ndikimi i pandemisë në sportin ndërkombëtar: Këtu trajtohet periudha kohore dhe rrethanat në të cilat u zhvillua sporti në arenën ndërkombëtare, sfidat dhe arritshmeritë e sportit, analizimi i aspekteve sociologjike, mbi ndikimin e pandemisë në sferat sportive, poashtu shtjellimi i problemeve psikosociale tek sportistët, në veçanti akterëve të fushës së futbollit. Krizat e mëdha financiare, bojkotimet e klubeve me renome botërore, analizimi i rreziqëve që u paraqitën si rezultat i pandemisë, ataket kardiake, rreziku i shkatërrimit të karrierave të sportistëve, humbja e vlerës së merkatove, tek sportistët. Të gjitha këto trajtohen brënda këtij kapitulli.

Kapitulli III – Ndikimi i pandemisë në industrinë e sportit: Në kuadër të këtij kapitulli, pasqyrohet një sistem shumë i rëndësishëm, nga i cili zhvillohet sporti në përgjithësi. Industria e sportit është instanca më e vlefshme në sistemet bashkëkohore të çdo industrije tjetër, andaj ky kapitull, shtjellon dëmet dhe pamjaftueshmërinë e zhvillimit të arënës sportive përgjatë pandemisë, poashtu kufizimet, duke filluar rregullat e virusit, të cilat ndikuan drejtëpërdrejtë në falimentimet dhe humbjet trilionëshe, si tek klubet, poashtu tek lojtarët dhe çdo sektor tjetër që zhvillon sistemi sportiv. Futbolli si një nga sferat më të pelqyera dhe të paguara njëkohësisht në botë, hasi në ngecjet dhe bankrotimet e çdo segmenti sportiv. Andaj, ky kapitull, shtjellon, pasqyron një realitet mbi trajtën e sportit më të ndjek

Pyetjet hulumtuese:

- Çfarë ndikimi kishte pandemia në zhvillimin e sportit vendor dhe ndërkombëtar?
- Cilat janë pasojat e pandemisë në sport, veçanërisht në futbollin vendor dhe ndërkombëtar?

Metodologjia e punimit:

Në temën me titull “Ndikimi i pandemisë në sportin vendor dhe ndërkombëtar”, si metodë kryesore është përdorur metoda kualitative, duke filluar nga intervistat gjysmë e strukturuar me lojtarë, trajnerë, tifozë dhe analistë sportivë. Përdorimi i literaturës, publikimeve, artikujve, fotografive dhe analizave , nga autorë botërore të kësaj fushe. Analizimi dhe shtjellimi i publikimeve dhe artikujve shkencorë mbi pandeminë dhe ndikimin e saj mbi fushat operuese mbi të cilat ushtrohen aktivitetet e shumta sportive. Hulumtimi është përmbushur me analizimin e një numri të madh të publikimeve dhe artikujve shkencorë, relevant me peridhuhën dhe temat përmes të cilave është trajtuar punimi.

